

Data 27/11/2025

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Ndërtimi i nyjeve multimodale të mobilitetit, Rajoni 3&4: Ndërtim i godinës së parkimit nëntokësor dhe i parkut shplohës, Vlorë.”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45000000-7.

Vlera e fondit limit: 509,044,650.74 Lekë pa TVSH. Programi buxhetor GOA. Kodi i Projektit 25AA502.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a) të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimi sipas shtojcës 8*)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përllogaritur e fondit limit në procedurën e prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe pika 2/b e nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë monetar dhe të ulët monetar.

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006,

"Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaraten vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji."

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2022, 2023, 2024** të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika "b", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjeshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaraten vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja b" të Ligjit nr. 1009/2009: "*Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: "b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësisë ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël".*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:

- Kontratën/at e Sipërmarrjes
- Fature tatimore e situacionit përfunditar të deklaruar në organet tatimore
- Situacioni përfundimtar
- Akt kolaudimi;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufiri të ulët dhe të lartë monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës. Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve. Licenca duhet të përmbajë kategoritë e punimeve të kontratës si më poshtë:

PËR PUNIMET E PËRGJITHSHME TË NDËRTIMIT

NP 1	B	Punime gjurmimi në tokë.
NP 4	E	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
NP 11	A	Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
NP 12	A	Punime të inxhinierisë së mjedisit.

PËR PUNIMET SPECIALE TË NDËRTIMIT

NS 2	B	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre
NS 3	A	Impiante ngritëse dhe transportuese
NS 6	A	Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.
NS 12	A	Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.
NS 14	A	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

ARGUMENTIMI LICENCAT

Kategorite janë kerkuar bazuar ne zerat dhe vlerat e punimeve, si me poshte:

Kategoria e kërkuar		Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit sipas kategorisë përkatëse	Vlera e punimeve, sipas kategorisë përkatëse
NP 1	B	Punime gërmimi në tokë.	Germim dheu themele e plinta me $b > 2m$, ekskavator me zinxhir 0.25m ³ , shkarkimi ne auto Hedhje, rrafshim, mbushje dheu me krah, kategoria IV Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km	21-50 milion lekë	25,803,044
NP 4	E	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.	F.V. Bordura betoni 12x25cm Suvatim me llac cim M 25, 50, ne mure betoni Bordura trotuari 25x12cm derdhur ne vend Nenshtrese rere Trotuar me pllaka, pa borduren e betonit Shtrese avullizoluese gjeotekstil Shtrese me pllaka grez porcelanato Shtrese me pllaka grez porcelanato Shtrese pllaka mermeri 3 cm Trotuar me pllaka, pa borduren e betonit Gjeotekstil me gramature 280 g/m ² Shtrese stabilizant t=15cm Shtrese çakelli t=8cm, perhapur e ngjeshur me makineri Shtrese betoni C 12/15	201-400 milion lekë	373,164,133

		Shtrese lluster cemento 1:2 Shtrese stirobetoni Shtrese lluster cemento 1:2 Shtrese stirobetoni Shtrese lluster çimento 1:2, t=30mm Shtrese termoizoluese me polisterol t=10 cm Veshje me pllake majolike Suva solete > 4 m, me drejtues, me krah Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25 Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25 Mur me tulla me 6 vrima, t=12cm h~3m, ll perz M 15 Mur me tulla me 8 vrima, t=10cm h~3m, ll perz M 15 Boje hidroplastike cilesi e larte Boje hidroplastike cilesi e larte Boje hidroplastike cilesi e larte Parapet shkalle e ballkone me tuba inoksi ngjyre e verdhe ose metalizato h = 80 ~ 90 cm F.V. Dyer te brendeshme druri cilesi e I-re. F.V. Dyer te brendeshme druri cilesi e II-te. Themel e xokol betoni C 12/15 Shtrese betoni me helikopter ((hardener i lartë, kurim i kontrolluar, polisht/anti-oil sealer) F.V. Dere kundra zjarrit REI60 te pajisur me doreze antipanik dhe mekanizem mbylles F.V. Kosha rrugor dekorativ F.V Kabine e biletarise (1.5x1.8) FV. Vetrare strukturale F.V. Dyer vetrare xhami F.V. Strukture metalike rrethore D-90cm per parkimin e bicikletave Spostim i bustit te Ismail Qemalit Nenshtrese zhavori Shtrese betoni C20/25 Pllake themeli, trare e bazamente b/a C 25/30 Breza b/a monolit C 16/20 Kapuç granili i derdhur ne vend per parapet tarace F.V. Hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm F.V. Hekur betoni periodik Ø > 12 mm Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama Hidroizolim me emulsion dhe 2 bitum Kasete shkarkimi me llamarine xingat Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100 Hidroizolim me dy shtresa astar me baze cemento. Pergatitur nga dy komponente A+B Shtrese termoizoluese me polisterol t=10 cm Mure b/a t = 21-30cm, h ~ 4m C 30/37 Kollona b/a monolite C 30/37 h ~ 4m	
--	--	---	--

			Soleta te plota b/a C 30/37, h~4 m Trare e arkitrare b/a C 30/37		
NP 11	A	Ndërtim për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.	F.V. Çelesa e priza 10 A me nulifikim F.V. Çeles 2 polar 220V 10A F.V. Tub plastmasi Ø 31-36mm F.V. Tub plastmasi Ø 22-26mm F.V. Tub plastmasi Ø 18-21mm F.V. Tub plastmasi Ø 14-17mm F.V. Priza shuko universal F.V. Kanaline metalike 150x50 F.V. Kanaline metalike 210x65 F.V. Tub plastmasi Ø 27-30mm F.V. Percjelles PV-500 Ø 1.5 mm ² F.V. Percjelles PV-500 Ø 2.5 mm ² F.V. Percjelles PV-500 Ø 4 mm ² F.V. Percjelles PV-500 Ø 6 mm ² F.V. Percjelles PV-500 Ø 10 mm ² F.V. Çeles 1 polar 220V 10A F.V. Kuader ndriçimi F.V. Automat kryesor me 24 vende F.V. Kasete plastike KE me 12 modular (vende) F.V. Kasete plastike KE me 36 modular (vende) F.V. Kasete plastike KE me 54 modular (vende) F.V. Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 32A, dl=0.03A F.V. Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 16A, dl=0.03A F.V. Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 10A F.V. Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 16A F.V. Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 32A F.V. Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 40A F.V. Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 63A F.V. Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar, L=1.5m F.V. Percjelles Tokezimi, Cu, S=50mm ² i zhveshur F.V. Percjelles shirit Zn 30x3mm F.V. Kasete metalike me zbara bakri 50x40x25cm per I=250A F.V. Automat termo-elektro magnetik, 4P; 380V; 40A F.V. Automat magneto-termik 380V, 40A, 4P, Id=0.03A F.V. Automat magneto-termik 380V, 63A, 4P F.V. Panel shperndares ne Tension te Ulet, komplet me 1 Automat 380V, 4P, 330A + 3 Automate 380V, 4P, 250A	0-20 milion lekë	18,323,456

		F.V. Sirene e brendshme audio vizive F.V. Llampe sinjalizimi 220V;1.2w F.V. Ndricules tip plafoniere, emergjence,1x18w, IP65 F.V. Ndricules tip spot me llampa fluoreshente,2x18w F.V. Ndricules pllafonier muror 1x60w F.V. Ndricules fluoreshent 4x18w, IP40 F.V. Ndricules fluoreshent 2x40w, IP40 F.V. Ndricules evakuimi me llampe 1x11w, IP40 F.V. Gjenerator 40KVA, diesel F.V. Priza shuko jashte murit 2P+T IP=54 F.V. Shtylla metalike per ndricim, H=7m, d=160mm F.V. Krah dy degesh per shtylla metalike F.V. Pusete elektrike kontrolli PVC 40x40x40cm F.V. Kuader komandimi komplet me santeri+fotoelement F.V. Pusete plastike 40x40x40, kapak te forte RIC 1084+1086 F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm F.V. Ne toke kablllo Cu fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulese plastmasi, te armuar, 4x25mm² F.V. Ne toke kablllo Cu fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulese plastmasi, te armuar, 3x95+50mm² F.V. Celsa e priza ndricimi me nulifikim brenda murit F.V. Celsa e priza ndricimi me nulifikim jashte murit F.V. Kuti shperndarese me kapak plastike 118x96x50mm F.V. Kuti shperndarese me kapak metalike 91x91x54mm Montim i paneleve TU Montim "Box" parafabrikat (2l+1t) (box parafabrikat perfshin: kabinen parafabrikat me permasa 4.2X2.2,h=2.2m, bazamentin e kabines 4.2X2.2,h=0.6m, setin e pajisjeve TM / TU,tokezimi I brendeshem ,ndricimi pa transformatorin e fuqise) Lidhje e ures kablllore TM/TU ne izolatoret e transformatorit F.V. Në tokë kabëll fuqie 20 kV alumin unipolar (flat), me izolim XLPE, (1x240) mm² Prize Data RJ45, Cat.6 Kabell data Cat.6, F/UTP Detektor optik tymi i adresueshem Ure TM xlpe 20 kV Cu (1x70) mm² Koka kablli te brendshme 20 kV Kapikorda me shtypje Cu -35 Xhunto 20 kV	
--	--	---	--

			Lidhje e ures kabllore TM/TU ne izolatoret e transformatorit Cele trasformatori Cele linje 24 kV Trasformator Fuqie 250 kVA 20/0.4 kV Panel I Tensionit te Ulet 4x 250 A		
NP 12	A	Punime të inxhinierisë së mjedisit.	Mbjellje bari ne skarpat F.V. Dhe humusore F.V. Shkurre dekorative Juniperus V.18 grup 3, cdo 6.6m F.V. Eucalyptus cinerea v.13 h.25 F.V Bar dekorativ mix, carex, festuca v.15 F.V CYCAS REVOLUTA V.14 H.50-70 Heqje e pemeve ekzistuese F.V Peme dekorative Magnolia grandiflora F.V Peme dekorative Bredh, picea abies F.V Peme dekorative Acer campestre	0-20 milion lekë	5,192,542
NS 2	B	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre	F.V. Lavaman porcelani F.V. WC allafrenga Panel alarmi zjarri me 3 loop-e i adresueshem, me 100 paisje te adresueshme F.V. Tub kanalizimi pvc Ø 200 Puse kontrolli 1x1x1.5m Pusete shiu 40 x 40, h = 100 cm, me kapak gize Pusete shkarkimi 80 x 80, h = 100 cm F.V. Tuba e rakorderi PPR Pn 20 f = 63 x 6.4 mm F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=40mm, Pn 16 F.V. Tuba e rakorderi PPR Pn 20 f = 50 x 5.4 mm F.V. Kolektor shpendares 3/4" (5+5) F.V. Saracineska bronzi Ø 1 " = 25 mm F.V. Saracineska bronzi Ø 3/4 " = 20 mm F.V. Saracineska bronzi Ø 1/2 " = 15 mm F.V. Tuba çeliku i zi F.V. Bolier 80 liter, uje te ngrohte F.V. Tubacionit multistrat PEX-AL-PEX, i përshtatshëm për instalime të sistemeve të ujit të ftohtë dhe të ngrohtë - Ø16 mm F.V. Tubacionit multistrat PEX-AL-PEX, i përshtatshëm për instalime të sistemeve të ujit të ftohtë dhe të ngrohtë - Ø20 mm F.V. Tub plastik, Pe-X 26,i termoizoluar ne fabrike. Kompletuar me gjithë, unaza bashkuese, "T" per ndarjen e degeve, reduksione, brryla, dhe te gjitha elemtet e tjere te nevojshem per montim. F.V. Tub plastik, Pe-X 32,i termoizoluar ne fabrike. Kompletuar me gjithë, unaza bashkuese, "T" per ndarjen e degeve, reduksione, brryla, dhe te gjitha elemtet e tjere te nevojshem per montim. F.V. Tub plastik, Pe-X 40, I pershtatshem per temperatura te larta deri ne 80o, dhe nje presion 6	21-50 milion lekë	29,276,658

		bar. Kompletuar me gjithë, unaza bashkuese, "T" per ndarjen e degeve, reduksione, brryla, dhe te gjitha elemntet e tjere te nevojshem per montim. F.V. Minivalvula per pajisjet sanitare me sferë DN 15 PN,16 Saraçeneska Sferike, bronzi I pershtatshme per perdorim per sistemin e shperndarjes se ujit sanitare DN 65, PN 10 Bar, F.V. Saraçeneska Sferike, bronzi I pershtatshme per perdorim per sistemin e shperndarjes se ujit sanitare DN 50, PN 10 Bar, F.V. Saraçeneska Sferike, bronzi I pershtatshme per perdorim per sistemin e shperndarjes se ujit sanitare DN 40, PN 10 Bar, F.V Tub shkarkimi PP-D160 mm, me gota dhe guornicione plastike F.V Tub shkarkimi PP-D125 mm, me gota dhe guornicione p F.V. Tub shkarkimi PP-D110 mm, me gota dhe guornicione plastike F.V Tub shkarkimi PP-D90 mm, me gota dhe guornicione plastike F.V Tub shkarkimi PP-D50 mm, me gota dhe guornicione plastike F.V RAKORDERI SHKAKRIMI PP, me gota dhe guornicione plastike F.V Tub PVC-U SN8 Ø100 mm, kompletuar me gjithë aksesoret e nevojshem per montim. F.V Tub PVC-U SN8 Ø125 mm, kompletuar me gjithë aksesoret e nevojshem per montim. F.V Tub PVC-U SN8 Ø160 mm, kompletuar me gjithë aksesoret e nevojshem per montim. F.V Tub PVC-U SN8 Ø200 mm, kompletuar me gjithë aksesoret e nevojshem per montim. F.V Tub PVC-U SN8 Ø250 mm, kompletuar me gjithë aksesoret e nevojshem per montim. F.V Goma dhe aksesore lidhjeje (kthesa, mufë, T, kapak) kompletuar me gjithë aksesoret e nevojshem per montim. V Pompë drenazhi me sensor + valvul + sistem mbylljeje (20–25 m³/h, H=10 m, 1.5 kW)e, kompletuar me gjithë aksesoret e nevojshem per montim. V. Pikë drenazhi vertikale për parkim, DN 100, me trup kompozit antikorroziv, flanxhë për shtresë hidroizoluese, kovë sedimentimi dhe kapak “Lock & Lift” me klasë ngarkese B125 (EN 124), kapacitet shkarkimi 4.5 l/s, sipas EN 1253-2. Përshtatshme për parkime me mbulesë betoni ose asfalti, temperatu F.V Pus drenazhi Ø1000 mm betoni, me kapak gize dhe bazament pompim, kompletuar me gjithë	
--	--	---	--

		aksesoret e nevojshem per montim. F.V Tabela drejtim dalje F.V. Saraçeneska Flutur,me dimensione DN 100, PN 10 Bar, F.V. Saraçeneska Flutur,me dimensione DN 65, PN 10 Bar, F.V. Xhunto Antivibruese, me dimensione DN 100, PN 10 Bar, V.Fikse zjarri V Grupi i lidhjes me motopompen per Hidrantet DN 65 VENDSOJE Valvul alarmi “Wet Alarm Valve” DN 100 PN V. Sprinkler Upright DN 15 MONTIM POMPE MNZSH + KOLEKTROI V. Hidrant i jashtëm tokësor DN 80 V. Hidrant i jashtëm BREND SHEM ME KASETE DN 45 Montim dhe instalim , venie ne pune te Ventilator “Jet Fan” për parkim nëntokësor F. Pikë drenazhi vertikale për parkim, DN 100, me trup kompozit antikorroziv, flanxhë për shtresë hidroizoluese, kovë sedimentimi dhe kapak “Lock & Lift” me klasë ngarkese B125 (EN 124), kapacitet shkarkimi 4.5 l/s, sipas EN 1253-2. Përshtatshme për parkime me mbulesë betoni ose asfalti, temperatur F.Fikse zjarri me gaz kimik , destinacioni per mbrojtjen nga zjarri, kapaciteti normal 6 kg, e kompletuar me gjithë mbajtëse metalike portative F.Fikse zjarr me CO2, destinacioni per mbrojtjen e paisjeve elektrike ne ndertes, kapaciteti normal 6kg. F Grupi i lidhjes me motopompen per Hidrantet DN 65. Vendosja ne kase te jashtme, llamarine çeliku te emaluar ne ngjyre, te kuqe RAL 3000, valvol sigurie dhe moskthimi 2 1/2" (DN 65) materiali i grupit bronz. F. Sprinkler Upright, K80, DN15, 1/2" BSP, 68°C, CE & UL Certified, materiali tunxh i kromuar, për montim në rrjet sprinkler me presion pune deri në 12 bar. Grup i MNZ – (sipas EN 12845) për sistemin e sprinklerave Grup pompash për sistemet automatike të fikjes së zjarrit (sprinkler), në përputhje me standardin EN 12845, përfshirë panelet e kontrollit dhe logjikën e komandimit sipas kërkesave të sigurisë. Përputhshmëri me standardet: EN 12845 – Sistem Grup i MNZ – Sistemi i hidranteve sipas EN 12845 Përdorim: Grup pompash për sistem fikjeje zjarri me hidrante (jo vetëm sprinklerë)	
--	--	---	--

			Standardet të përmbushura: EN 12845 – Sisteme fikje automatike me sprinklerë / hidrante EN 60204-1 – Pajisja elektrike e makinerive EN 61439-1/-2 – Panele kontrolli m Valvul alarmi “Wet Alarm Valve” DN 100 PN 16, trup gize EN-GJS-500-7 me veshje epokside, me komplet “Trim Set” (presostat, gong hidraulik, valvul drenazhi dhe testimi), e certifikuar sipas EN 12259-2 / EN 12845 / UL / FM / CE, për sisteme sprinkler me ujë (Wet System). Montim vertikal në linj		
NS 3	A	Impiante ngritëse dhe transportuese	Montim ashensori Ashensor	0-20 milion lekë	2,156,749
NS 6	A	Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.	Vizime me boje bikomponente F.V. Tabela te ndryshme rrugore D=60cm F.V. Tabelat treguese dhe sinjalizuese per hyrjen ne parkim (55x325) F.V. Pasqyrë rrugore, D60 cm	0-20 milion lekë	625,210
NS 12	A	Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.	F.V. Kanale ajri prej llamarine te galvanizuar F.V. tubacionit fleksibël termoizoluar DN 125 mm F.V. Tubacionit fleksibël termoizoluar DN 100 mm F.V. i grilës ajrore për furnizim ose kthim ajri, me përmasa 425x125 mm, e ndërtuar me 2 rreshta lamelash të rregullueshme, për drejtimin optimal të rrjedhës së ajrit në mjedise të brendshme. F.V. grilës ajrri tipi disk (valvul disk-u), me diametër Ø125 mm F.V Tub bakri (1/4") Ø 6.35 mm, spesor 0,70 mm, me t.izolim δ 9 mm F.V Tub bakri (3/8") Ø 9.52 mm, spesor 0,80 mm, me t.izolim δ 9 mm F.V. Tub bakri (1/2") Ø 12.70 mm, spesor 0.80 mm, me t.izolim δ 9 mm F.V. Tub bakri (5/8") Ø 15.88 mm, spesor 1.00 mm, me t.izolim δ 9 mm Tub bakri (3/4") Ø 19.05 mm, spesor 1,00 mm, me t.izolim δ 9 mm F.V. Degezus per paisje te brendeshme Y 18-28 kW, F.V. Grilë alumini SHIU, 800 x 200 mm F.V. termostatit UTY-RNRYZ5 për kontroll njësie VRF F.V. Tubacionit fleksibël termoizoluar DN 200 mm F.V. Tubacionit fleksibël termoizoluar DN 300 mm Kabell komunikimi i skermuar per komunikimin ndermjet paisjeve te brendshme dhe te jashtme. Tub per kondensat gri 32-40mm	0-20 milion lekë	12,145,461

		Atrecature ndihmese (nastro alumini, upa metalike, ngjites, prixhionier M10, silikon) Gaz frigoriferik R410 A, per sistemin e kondicionimit. INSTALIM PAISJE TE BRENDSHME KONDICIONIMI INSTALIM PAISJE E JASHTME MINI VRV INSTALIM PAISJE RIKUPERIMI AJRI INSTALIM PAISJE VENTILATORI F. Pajisje e brendeshme VRF FULL DC INVERTER , Modeli Cassette, 18000 BTU/h, Kapaciteti termik - Ftohje - 4.5 kW / Ngrohje - 5 kW, Fuqia elektrike Pmax-35 W, 1F~230V~50Hz, Sasia max e ajrit: 680 m³/h, Dim-245*570*570 mm, Pesha- 15 kg, Niveli Zhurmes 27/38 dB(A), VENTILATOR LINEAR “SILENT” Ventilator kanalor axial-centrifugal i tipit Silent, me trup ABS/PP të izoluar akustikisht, për ventilim të vazhdueshëm në ambiente të brendshme. Prurja: 400 m³/h Presioni statik: 125 Pa Fuqia elektrike: 65 W Tensioni: 230 V – 50 Hz – 1~ Diametri lidhjes: Ø 125 mm Zh VENTILATOR LINEAR “SILENT” Ventilator kanalor axial-centrifugal i tipit Silent, me trup ABS/PP të izoluar akustikisht, për ventilim të vazhdueshëm në ambiente të brendshme. Prurja: 300 m³/h Presioni statik: 125 Pa Fuqia elektrike: 65 W Tensioni: 230 V – 50 Hz – 1~ Diametri lidhjes: Ø 125 mm Z VENTILATOR LINEAR “SILENT” Ventilator kanalor axial-centrifugal i tipit Silent, me trup ABS/PP të izoluar akustikisht, për ventilim të vazhdueshëm në ambiente të brendshme. Prurja: 800 m³/h Presioni statik: 125 Pa Fuqia elektrike: 65 W Tensioni: 230 V – 50 Hz – 1~ Diametri lidhjes: Ø 125 mm Zh Rregullator mekanik me 3 shpejtësi për kontrollin e ventilatorëve (I–II–III). Përshtatet me motorë njëfazësh 230 V. Montim në mur (flush / surface). Kapsulë plastike e bardhë, dizajn modern. Furnizimi: 230 V AC Shkallë kontrolli: 3 Konsum: < 5 W Mbrojtje: IP30 Për përdorim në sisteme ventilimi dh Rikuperator ajri–ajer (HRV) Njësi ventilimi me rikuperim nxehtësie ajër-ajër, pa bateri ngrohjeje/ftohjeje. Kapacitet: 1 000 m³/h Presion statik: ≈ 150 Pa Efikasitet rikuperimi: ≈ 85 %Furnizimi: 230 V / 50 Hz Motorë: EC me konsum të ulët dhe zhurmë minimale Konstruksion: Trup me panele të dyfish Rikuperator ajri–ajer (HRV) Njësi ventilimi me	
--	--	---	--

			rikuperim nxehtësie ajër-ajër, pa bateri ngrohjeje apo ftohjeje. Kapacitet: 2 000 m³/h Presion statik: ≈ 210 Pa Efikasitet rikuperimi: ≈ 85 % Furnizimi: 230 V / 50 Hz Motorë: EC me konsum të ulët dhe zhurmë minimale Konstruksion: Trup me panele të Njësi e brendshme + JASHTME (Indoor + Outdoor Split/VRV) Indoor Unit (Brendshme): Model: D — kasetë ultra-flat për tavan standard 600×600 mm. Kapacitet nominal për ftohje: rreth 5.0 kW. Furnizim elektrik: 230 V / 50 Hz – 1 fazë. Trashësi trupit: ~260 mm. Dizajn i integruar në tavan me Njësi e jashtme Outdoor VRV IV, 22.4 kW ftohje, inverter, R-410A. Instalim komercial 3 fazor (380-415V 50Hz). Dimensione kompakte (940×1430×320mm) dhe pesha ~144 kg. Efikasitet i lartë sezonal me teknologji VRT dhe funksion “Night Quiet”. Mund të lidhet me deri në 64 njësi të brendshme. P Njësi e jashtme VRV IV për sistem HVAC me ftohje dhe ngrohje. Projektuar për ndërtesa me hapësirë të kufizuar, ofron kapacitete nominale nga ~12 kW deri ~15.5 kW, teknologji inverter, gaz R-410A, dhe funksion të avancuar VRT për efikasitet energjetik të përmirësuar. Instalim i jashtë Konstruksioni metalik për paisjen e jashtme Ventilator “Jet Fan” për parkim nëntokësor, Tipi: Jet Fan axial – rrjedhje njëkahëshe ose dykahëshe Kapaciteti i ajrit: 3,000 – 8,000 m³/h Presioni statik: 150 – 300 Pa Fuqia elektrike: 0.75 – 2.2 kW Tension furnizimi: 400 V / 50 Hz / 3~ Klasa e mbrojtjes: IP55 Klasa e izolimit: F Temperatur		
NS 14	A	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.	Kombinator telefonik me dy kanale deri në 4 thirrje telefonike Kamera IP e Brendshme, 5MP Kompiuter Monitorimi përfshirë programin Regjistruar NVR (Network Video Recorder) me 16 kanale dhe 16 porta PoE UPS 3 Phase On-Line 10kVA/10kW Karikues makine 16 A 3-Ph 7 kW Sistemi i Menaxhimit të Parkimit Kit Komplet me të gjitha pajisjet përfshi traret dhe komandimet Tabele LED për postet e disponueshme në hyrje të parkimit Rack 22HU 600x600mm duke përfshirë të gjithë aksesoret 1HU Switch 24 Porta me 2 Ethernet/SFP Uplink ports komplet aksesoret	0-20 milion lekë	3,682,000
NS 18	A	Punime topogjeodezike	Referuar projektit të zbatimit dhe relacionit teknik	0-20 milion lekë	-

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë:

- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (nje) Inxhinier Mjedis
- 1 (nje) Inxhinier Gjeodet

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit 2.3.3 operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diploma
- CV
- Kontrata e punës

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e personelit kryesor në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces nr.8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Staf Mbështetës

1 (Nje) Projektues Arkitekt (Licensa 2 a, d: Projektim arkitekturor për - objekte industriale - objekte turistike, Projektim peizazh, sistemime sipërfaqe të gjelbra, lulishte e parqe.)

1 (Nje) Projektues Konstruktor (Licensa 3 a: Projektim objekte civile – industrial – turistike, prej murature dhe skelet beton arme deri në 5 kate.)

1 (Nje) Projektues Instalator (Licensa 4 a,b,c,j:Projektim të instalimeve hidro-termosanitare, Projektim të instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme-Projektim të linjave të rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale-Projektim të sistemeve kundër zjarrit- Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industriale).

Stafi i sipërcituar është staf mbështetës për përgatitjen e projektit të zbatimit (Faza V-VI).

Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për projekte të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas përcaktimit në vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”.

Për secilin punonjës të paraqitet diploma, kontrata e punës dhe CV.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, specifikimet teknike, raportin teknik dhe vëllimet e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast

rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin objektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës

